



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:288684

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05750614

**C.nr.383/21**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit të cilin e përfaqëson sipas autorizimit e përfaqëson Shoqeria e Avokateve “K. &ASS.” nga Prishtina, Rr. “Bl. D. K.”, Ul. C-..., 2/.. hyrja 1., kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, të cilën e përfaqëson i autorizuari Islam Rexheplari nga Dragashi, me bazë juridike kompensimin e shujtave ditore gjatë punës, vlera e kontestit 962.00 €, jashtë shqyrtimi, me dt. 29.05.2024 mori këtë:**

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit E. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Dragash, që paditësit E. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, në emër të kompensimit të shujtave gjatë punës për ditët e pranisë në punë për 481 ditë pune nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, duke llogaritur prej dates 01.01.2019 deri me datën 02.07.2021, **t’ia paguajë paditësit shumën e përgjithshme prej 962.00 € (nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy euro)**, me kamat ligjore duke llogaritur në lartësi 8%, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

**III. DETYROHET** e paditura Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro.

## **A r s y e t i m**

Paditësi E. K. nga fshati..., Komuna e Dragashit, përmes përfaqësuesit të autorizuar pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi me 17.12.2021, kundër të paditurës Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale në Dragash, për kompensimin e shpenzimit të ushqimit gjatë ditës (shujtave ditore), të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 14.03.2024, **ku çështjen e ka paraqitur si në vijim:**

Paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (tutje: SHFMU) “... N.” në fshatin..., Komuna e Dragashit në pozitën e Mësimdhënësit të Artit Figurativ që nga viti shkollor 1995/1996 e deri tani. Tutje, ka theksuar se e paditura Komuna e Dragashit përkundër obligimeve dhe të drejtat të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, konform dispozitave të nenit 35 pika 7 e kësaj marrëveshjeje, nuk ka bërë kompensimin e shujtave ditore dhe atë nga 2 euro për ditët e pranisë në punë, duke

propozuar gjykatës aprovimin padisë dhe detyrimin e të paditurës që të bëjë pagesën e shpenzimeve të ushqimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar ka parashtruar përgjigjen në padi përmes parashtresës së datës 30.11.2023 duke e kontestuar në tërësi padinë e paditësit, me arsyetimin se Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 i ka kaluar afati dhe nuk ka bazë ligjore dhe nuk prodhonë efekt juridik, edhe atë duke u bazuar në ligjin e punës afati i kontratës kolektive ka zbatim 3 vjet. Sipas shiqimit të të kontratës së punës, paditësi ka filluar pune me datë 01.09.2020, kurse sipas Verttimit të lëshuar me datë 14.06.2021 Nr.179/21 nga SHFMU "... N." Br. paditësi ka filluar punë me datë 01.01.2020 dhe i janë llogaritur ditet e punës. Mbi bazën e tillë i ka propozuar gjykatës refuzimin e padisë si jo të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

Gjykata duke parë mos kompleksitetin e lëndës dhe veçanërishtë edhe praktikën gjyqësore të krijuar rreth këtyre lëndëve por gjithashtu edhe parimit të efikasiteti dhe ekonomizimit të procedurës paraparë me dispozita procedurale, përmes Aktvendimit të dt. 26.02.2024 i ka derguar paditësit padinë në plotësim dhe precizim, veprim të cilën përfaqësuesi i paditësit e ka bërë përmes parashtresës së datës 07.05.2024.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se *"Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhenjen e vendimit meritot, atëher ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jepë aktgjykimin me të cilën e pranon si të themelt kërkesëpadinë"*.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka lexuar kontratën Nr.163/2020 të dt. 01.09.2020, Vërtetimin Nr.79/2021 e dt. 14.06.2021, Diploma Nr.3221 e datës 22.11.2013, Lista e pagave në emër të paditësit.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se:

Kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar** nga arsytet e cekura si më poshtë:

Nga Listat e pagave në emër të paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi pagën bazë e ka në shumë prej 421.00 euro.

Nga Kontratat e punës në emër të paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura në kohë të caktuar nga data 01.09.2020 e deri më 31.08.2021 dhe me kontratë II.

Nga Diploma e Arsimit të Lartë Nr.3221 e dt. 22.11.2013 në emër të E. (S.) K., gjykata vërtetoi faktin se paditësi me datë 30.10.2013, i ka përfunduar studimet në Universitetin e Novi Sadit, Republika e Serbisë, Fakulteti i Artëve Aplikative dhe ka marrë titullin "Profesor i Artit Figurativ".

Nga administrimi i Vërtetimit mbi stazhin e punës lëshuar nga SHFMU "... N." në fshatin Br. Nr.79/2021 e datës 14.06.2021, gjykata vërteton se paditësi E. K. nga data 01.01.2019 deri më

31.12.2019 ka punuar në këtë shkollë 185 ditë, nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2020 ka punuar 185 ditë dhe nga data 01.01.2021 deri më 02.07.2021 ka punuar 111 ditë.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe neni 399.1 që përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është i punësuar te e paditura në cilësinë e mësimdhënësit (fakt i vërtetuar edhe nga kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar me nr. prot. 163/20, dt. 01.09.2020 dhe vërtetimi me nr. 79/21 dt.14.06.2021); nuk është kontestues fakti se i njëjti është me kualifikim shkollor fakultet (fakti vërtetuar nga diploma me nr.3221 e dt. 22.11.2013); paga bazë e tij është 421.00 euro, si dhe fakti që i njëjti nga data 01.01.2019 e deri me datën 02.07.2021 ka gjithsejtë 481 ditë pune (fakt i vërtetuar në bazë të Vërtetimit Nr.79/2021 të dt. 14.06.2021).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, prova në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjithashtu sa i përket të drejtës për pagesë e shujtave, në dispozitën ligjore të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 18.04.2017 (dhe asaj pasuese e datës 22.01.2021) me të cilën është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’a bërë kompensimin”*. Së këndejmi, rezulton se punëdhënës i paditësit është e paditura në këtë rast, Komuna e Dragashit, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). Ndërsa, sipas nenit 2 par. 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë shprehimisht precizohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*. Andaj, mbi bazën e kësaj që u paraqit, sipas raportit juridik të paditësit me të paditurën, këtë të fundit e bën plotësisht legjitime dhe me kompetencë për pagesën e detyrimeve sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare, e as gjendjen faktike, por vetëm bazën e kërkesëpadiës, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadiës së paditësit e aprovuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se *“I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*; nenit 90, paragrafi 5 se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen*

*e tillë Kolektive”;* lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dates 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se *“I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtores, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”;*

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017– 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Meqë e paditura ka kontestuar afatshmërinë e padisë, gjykata ka gjetur se paditësi ka paraqitur kërkesën (padinë) më dt. 17.12.2021, ndërsa kompensimin sa i përket shujtave e ka kërkuar nga viti 2019 e deri më 02.07.2021. Bazuar në nenin 7 të Ligjit të Punës që përcakton se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, gjykata ka vlerësuar se paditësi ka pasur të drejtë të parashtrojë kërkesën duke llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e paraqitjes së saj.

Ndërsa sa i përket vlerësimit rreth shujtave gjykata ka vlerësuar se nga data 01.01.2019 – 02.07.2021 sa edhe ka qenë kërkesa e paditësit për ditët e pranisë në punë, për gjithsejt 481 ditë pune nga dy (2) euro për një ditë, t’i paguaj shumën prej 962.00 euro për shujta dhe si i tillë një vlerësim për gjykatën ka qenë i thjeshtë dhe për këtë arsye edhe nuk ka angazhuar ekspertizë përkatëse financiare duke synuar parasëgjithash ekonomizimin e procedurës.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, për përpilimin e padisë shumën 104.00 euro dhe për taksën gjyqësore në shumë prej 20.00 euro apo shumën totale prej 124,00 euro.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2021:288684, 29.05.2024**

**G j y q t a r j a,**

**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, e cila duhet të parashtrohet në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, ndërsa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.